

LIGJ
Nr. 42/2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2014, “PËR
PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:
“1/1. “Agjencia e Zhvillimit të Territorit” është institucion që ka përgjegjësi zhvillimin e territorit dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit.”.

Neni 2

Në nenin 7 bëhen ndryshimet si më poshtë:
1. Në paragrafin e parë, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:
“ç) KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj.”.
2. Në paragrafin e dytë, pas fjalëve “Pranë Këshillit Kombëtar të Territorit funksionon sekretariati teknik i këtij këshilli” shtohen fjalët “Agjencia e Zhvillimit të Territorit”.

Neni 3

Në nenin 25, pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:
“4/1. Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar, jo më vonë se 15 ditë pas botimit në regjistrin e planifikimit të territorit, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrim, planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, sipas rastit, ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit.”.

Neni 4

Në nenin 28, në fund të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj.”.

Neni 5

Në nenin 38, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor. Në rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, leja e zhvillimit jepet sipas përcaktimeve në rregulloren e zhvillimit. Autoriteti përgjegjës, jo më vonë se 15 ditë nga miratimi, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrim, lejen e zhvillimit. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të lejes.”.

Neni 6

Në nenin 42, pika 1, fjalët “autoriteti përgjegjës i planifikimit” zëvendësohen me fjalët “autoriteti përgjegjës i zhvillimit”.

Neni 7

Në nenin 44, pika 2, pas fjalëve “brenda 60 ditëve” shtohet fjala “pune”.

Neni 8

Në nenin 48 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në titullin e nenit, pas fjalëve “Rishikimi i kushteve të lejes” shtohen fjalët “dhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit”.

2. Në pikën 2, pas fjalës “Rishikimi”, shtohen fjalët “i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Rastet kur kërkohet rishikimi i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit, si dhe procedura, sipas përcaktimeve të këtij neni, kryhen sipas rregullores së zhvillimit.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 4.7.2019